

## Deklarata e Bejrutit për “Besim për të Drejta” (F4R)

*“Drejt Perëndisë ka po aq rrugë sa ka shpirtra në Tokë.” (Rumi)<sup>1</sup>*

1. Ne, aktorët e besimit dhe të shoqërisë civile që punojmë në fushën e të drejtave të njeriut dhe që u mblodhëm në Bejrut më 28-29 mars 2017, në pikën kulmore të vazhdës së takimeve të inicuar nga Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR),<sup>2</sup> shprehim bindjen tonë të thellë se fetë dhe besimet tona fetare përkatëse ndajnë një zotim të përbashkët për të **mbështetur dinjitetin dhe vlerën e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore**. Vlerat e përbashkëta njerëzore dhe dinjiteti i barabartë, pra, janë rrënjët e përbashkëta të kulturave tona. Besimi dhe të drejtat duhet të jenë sfera reciprokisht përforcuese. Shprehja individuale dhe shoqërore e feve apo besimeve bulëzon dhe lulëzon në mjediset ku mbrohen të drejtat e njeriut bazuar në vlerën e barabartë të të gjithë individëve. Në mënyrë të ngjashme, të drejtat e njeriut mund të përfitojnë nga themele të rrënjësura thellë, etike dhe shpirtërore, të ofruara nga feja ose besimet.

2. Ne i kuptojmë bindjet tona përkatëse fetare apo të besimit si një burim për mbrojtjen e të **gjithë spektrit të të drejtave të patjetërsueshme të njeriut** - nga ruajtja e dhuratës së jetës, liritë e mendimit, ndërgjegjes, fesë, besimit, mendimit dhe shprehjes deri te liria nga skamja dhe frika, duke përfshirë lirinë nga dhuna në të gjitha format e saj.

- *“Kushdo që ruan një jetë, sipas Shkrimit konsiderohet sikur të ketë ruajtur të gjithë botën.” (Talmud, Sanhedrin, 37,a).*
- *“Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.” (Kurani 5:32)*
- *“Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë forcën tënde dhe me gjithë mendjen tënde, edhe të afërmin tënd porsi vetveten.” (Luka 10:27)*
- *Le ta adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie që i shpëtoi ata nga uria dhe i shpëtoi nga frika.” (Sourat Quraish, vargjet 3, 4)*
- *“Një person i vetëm u krijua në botë, për të mësuar se në qoftë se dikush shkakton një person të vetëm të shuhet, ai ka shkatërruar të gjithë botën; dhe nëse dikush shpëton një shpirt të vetëm, ai ka shpëtuar të gjithë botën.” (Mishna Sanhedrin 4:5)*
- *“Le të qëndrojmë së bashku, të japim deklaratë kolektive dhe mendimet tona u bëfshin një.” (Rigveda 10:191:2)*
- *“Ashtu si unë mbroj veten nga gjërat e pakëndshme sado të vogla qofshin, në të njëjtën mënyrë unë duhet të veproj ndaj të tjerëve me një mendje të dhembshur dhe të kujdesshme.” (Shantideva, Udhëzues për Mënyrën e Jetës së Bodhisattva-s)*
- *“Le t’i bëjmë bashkë mendjet tona për të parë se çfarë jete mund të bëjmë për fëmijët tanë.” (Shefi Bualli i ulur, Lakota)*

3. Bazuar në sa më sipër, në mesin e shumë burimeve tjera të besimit, ne jemi të bindur se tona **bindjet fetare apo të besimit janë një nga burimet themelore** të mbrojtjes së dinjitetit dhe lirive të të gjithë individëve dhe komuniteteve pa asnjë dallim mbi çfarëdo bazë. Tekstet fetare, etike dhe filozofike i kanë paraprirë të drejtës ndërkombëtare në ruajtjen e njëshmërisë së njerëzimit, shenjtërisë së të drejtës për jetë dhe detyrave përkatëse individuale dhe kolektive që janë të ngulitura në zemrat e besimtarëve.

4. Ne marrim detyrimin për të shpërndarë **vlerat e përbashkëta njerëzore që na bashkojnë**. Ndërsa ne ndryshojmë në disa pyetje teologjike, ne marrim përsipër luftimin e çdo forme të shfrytëzimit të dallimeve të tilla për të avokuar dhunën, diskriminimin dhe urrejtjen fetare.

- *Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t’ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti.” (Kurani 5, 48)*
- *“Ju jeni frytet e një peme, dhe gjethet e një dege.” (Bahá’u’lláh)*

5. Ne besojmë se liria e fesë apo besimit nuk ekziston pa **lirinë e mendimit dhe të ndërgjegjes** që i paraprijnë të gjitha liritë, sepse ato janë të lidhura me thelbin e njeriut dhe të drejtat e tij/saj për të zgjedhur dhe lirinë e fesë apo besimit. Një person si një tërësi është baza e çdo besimi dhe ai/ajo rritet përmes dashurisë, faljes dhe respektit.

6. Ne, nëpërmjet kësaj, së bashku nga Bejruti solemnisht po nisim **betejën më fisnike nga të gjitha, paqësore por të fuqishme**, kundër egove tona, vetë-interesit dhe ndasive artificiale. Vetëm kur ne si aktorë fetarë të marrim rolet tona përkatëse, të artikulojmë një vizion të përbashkët të përgjegjësive tona dhe të shkojmë përtej predikimit në veprim, vetëm atëherë do të promovojmë besueshëm pranimin e ndërsjellë dhe vëllazërinë mes njerëzve të feve ose besimeve të ndryshme, dhe do t'i fuqizojmë ata për të mposhtur impulset negative të urrejtjes, ligësisë, manipulimit, lakmisë, mizorisë dhe formave të ngjashme çnjerëzore. Të gjitha bashkësitë fetare apo të besimit kanë nevojë për një udhëheqje të vendosur që pa mëdyshje trason këtë rrugë duke vepruar për dinjitet të barabartë të të gjithëve, drejtuar nga humanizmi ynë i përbashkët dhe respekti për lirinë absolute të ndërgjegjes së çdo qenieje njerëzore. Ne marrim detyrimin që të mos kursejmë asnjë përpjekje në plotësimin e këtij boshllëku të lidhësive të përbashkët duke mbrojtur lirinë dhe diversitetin nëpërmjet aktiviteteve të "besimit për të drejta".

➤ *"Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë."* (Kurani 91, 7-9)

7. Kjo deklaratë për "Besim për të Drejta" i bën thirrje **personave që u përkasin feve dhe besimeve në të gjitha rajonet e botës**, me qëllim të rritjes së shoqërive kohezive, paqësore dhe respektuese në bazë të një platforme të përbashkët të orientuar kah veprimi të rënë dakord nga të gjithë të interesuarit dhe të hapur për të gjithë aktorët që ndajnë objektivat e saj. Ne vlerësojmë se deklarata jonë për Besim për të Drejta, si edhe pararendësi i saj themelues Plani i Veprimit i Rabatit mbi nxitjen e diskriminimit, armiqësisë dhe dhunës (tetor 2012), janë konceptuar dhe realizuar nën kujdesin dhe me mbështetjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara që përfaqëson të gjithë popujt e botës, dhe janë begatuar me mekanizmat për të drejtat e njeriut të OKB-së, të tillë si Raportuesit Specialë dhe anëtarët e Trupave të Traktateve.

8. Ndërsa iniciativa të shumta të mirëpritura kanë bërë përpjekje me kalimin e kohës për të lidhur besimin me të drejta për të mirën e të djave, asnjë prej këtyre përpjekjeve nuk e kanë arritur plotësisht këtë qëllim. Prandaj ne jemi të bindur se **aktorëve fetarë**, si kombëtarë ashtu edhe ndërkombëtarë, **duhet t'i mundësohet** që të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre në mbrojtjen e njerëzimit tonë të përbashkët nga nxitja e urrejtjes, ata që përfitojnë nga shoqëritë e destabilizuara dhe manipuluesit e frikës në dëm të një dinjiteti njerëzor të barabartë dhe të patjetërsueshëm. Me këtë Deklaratë F4R, ne kemi për qëllim që t'i bashkojmë duart dhe zemrat duke ndërtuar mbi përpjekjet e mëparshme për të sjellë më afër besimin dhe të drejtat **duke artikuluar arsyet e përbashkëta** midis të gjithë nesh dhe **duke përcaktuar mënyrat në të cilat feja mund të angazhohet për të drejta** në mënyrë më efikase ashtu që të dyja ta rritin njëra-tjetrën.

➤ *"Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin."* (Kurani 103, 3)

9. Duke u bazuar në deklaratën e sotme, ne gjithashtu synojmë që ta **praktikojmë atë që predikojmë** përmes krijimit të **një koalicioni shumënivelesh**, të hapur për të gjithë aktorët e pavarur fetarë dhe organizatat me bazë fetare që me të vërtetë tregojnë pranimin e, dhe zotimin ndaj, kësaj deklaratë F4R duke zbatuar projekte në terren në fushat që kontribuojnë në arritjen e qëllimit të saj. Ne gjithashtu do ta vizatojmë një udhërrëfyes për veprime konkrete në fusha të caktuara, që do të rishikohen rregullisht nga koalicioni ynë global i Besimit për të Drejta.

10. Për të arritur synimin e mësipërm, ne marrim detyrimin si besimtarë (qoftë teistë, joteistë, ateistë apo të tjerë<sup>3</sup>) për t'iu përmbajtur plotësisht **pesë parimeve themelore**:

- a) Shkuarja përtej dialogëve tradicionalë ndërjetarë në **projekte konkrete të Besimit për të Drejta të orientuara kah veprimi në nivel lokal**. Ndërsa dialogu është i rëndësishëm, ai në vetvete nuk paraqet një synim. Qëllimet e mira kanë vlerë të kufizuar pa veprimin përkatës. Ndryshimi në terren është qëllimi dhe veprimi i bashkërenduar është mjeti i tij logjik.
- *“Besimi është i ngulitur në zemër kur ai demonstron me vepra.” (Hadith)*
- b) **Shmangia e ndasive teologjike dhe doktrinare** në mënyrë që të veprohet në fushat e vizionit të përbashkët ndërjetar dhe të ndërbesimit siç përcaktohet në këtë deklaratë F4R. Kjo deklaratë nuk është konceptuar të jetë një mjet për dialog mes feve, por më tepër si një platformë e përbashkët për veprim të përbashkët në mbrojtje të dinjitetit njerëzor për të gjithë. Ndërsa ne respektojmë lirinë e shprehjes dhe nuk marrim parasysh asnjë iluzion në lidhje me vazhdimin e një niveli të polemikave në nivele të ndryshme të diskursit fetar, ne jemi të vendosur për të sfiduar manipulimin e feve si në politikë ashtu edhe në konflikte. Ne synojmë që të jemi një zë i bashkuar baraspeshues i solidaritetit, arsyes, dhembshurisë, moderimit, iluminizmit dhe veprimit përkatës kolektiv në nivelin bazë.
- c) Të qenit **introspektiv** është një virtyt që ne e kemi për zemër. Të gjithë ne ngrisim zërin dhe veprojmë para së gjithash në bazë të vetë dobësive dhe sfidave brenda komuniteteve tona përkatëse. Ne do të trajtojmë më shumë çështje globale në mënyrë kolektive dhe konsistente, pas shqyrtimit të brendshëm dhe gjithëpërfshirës që ruan forcën tonë më të çmuar, pra integritetin.
- d) **Të folurit me një zë**, veçanërisht kundër çdo avokimi të urrejtjes që përbën nxitje të dhunës, diskriminimit ose çfarëdo shkeljeje tjetër të dinjitetit të barabartë që gëzojnë të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga feja, besimi, gjinia, mendimi politik ose tjetër, prejardhja kombëtare ose shoqërore, apo ndonjë status tjetër i tyre. Denoncimi i nxitjes së urrejtjes, padrejtësive, diskriminimit në baza fetare apo çfarëdo forme të mostolerancës fetare nuk është i mjaftueshëm. Ne e kemi për detyrë që të korrigjojmë gjuhën e urrejtjes me dhembshuri dhe solidaritet përmirësues që shëron zemrat dhe shoqëritë njësore. Fjalët tona të korrigjimit duhet të kapërcejnë kufijtë fetarë apo të besimit. Andaj, kufijtë e tillë nuk duhet të mbeten si një tokë e lirë për manipuluesit, ksenofobët, populistët dhe ekstremistët e dhunshëm.
- e) Ne jemi të vendosur për të **vepruar në një mënyrë plotësisht të pavarur**, duke iu bindur vetëm ndërgjegjes tonë, ndërsa kërkojmë partneritet me autoritetet fetare dhe sekulare, organet relevante qeveritare dhe aktorët joshtetërorë kudo që koalicionet e Besimit për të Drejta (F4R) janë themeluar lirisht në përputhje me këtë deklaratë.

11. **Mjeti dhe aseti ynë kryesor është thirrja që i bëjmë qindra miliona besimtarëve** në mënyrë të strukturuar parandaluese për të përcjellë bindjet tona të përbashkëta të mishëruara në këtë deklaratë F4R. Të folurit me një zë në mbrojtje të dinjitetit të barabartë për të gjithë në çështjet e sfidave të përbashkëta të njerëzimit, në mënyrë të barabartë i shërben çështjes së besimit dhe të drejtave. Qeniet njerëzore gëzojnë të drejtën për respekt të plotë dhe të barabartë, dhe jo thjesht tolerancë, pavarësisht se në çka ata besojnë ose nuk besojnë. Është detyra jonë që të mbështesim këtë zotim brenda sferave tona përkatëse të kompetencës. Ne gjithashtu do të inkurajojmë të gjithë besimtarët që të marrin përgjegjësitë e tyre individuale në mbrojtje të vlerave të tyre të mbajtura thellësisht të drejtësisë, barazisë dhe përgjegjësisë ndaj nevojtarëve dhe të pafavorizuarve, pavarësisht fesë apo besimit të tyre.

- *“Njerëzit janë ose vëllezërit e tu në fe, ose vëllezërit e tu në njerëzim.” (Imam Ali ibn Abi Talib)*
- *“Në udhëtimin e gjatë të jetës njerëzore, Besimi është më i miri bashkudhëtar.” (Buddha)*

12. Ne kemi për qëllim ta arrijmë këtë synim në një mënyrë konkrete që ka rëndësi **për njerëzit në nivelin bazë** në të gjitha pjesët e botës, ku koalicionet e aktorëve fetarë zgjedhin t’i përmbahen kësaj

deklarate dhe të vepronë përshtatshëm. Ne do të mbështesim veprimet e njëri-tjetrit, duke përfshirë një Ecje të Besimit për të Drejta tejet simbolike vjetore të shprehjes më të begatshme të unitetit tonë në diversitet, çdo 10 dhjetor në të gjitha pjesët e botës.

13. Artikulimi përmes kësaj deklarate i një vizioni të përbashkët të aktorëve fetarë, në bazë të Planit të Veprimit të Rabatit të vitit 2012 dhe takimeve pasuese, do të sigurojë një pikë kthese për **çarmatosjen e forcave të errësirës**; dhe do të ndihmojë në shpartallimin e aleancës së mëkatshme në shumë zemra mes frikës dhe urrejtjes. Dhuna në emër të fesë mposht themelet bazë të saj, mëshirën dhe dhembshurinë. Ne synojmë transformimin e mesazheve të mëshirës dhe dhembshurisë në vepra të solidaritetit përmes projekteve ndërkomunitare shoqërore, zhvillimore dhe mjedisore të bazuara në besim në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe global.

14. Ne **përqafojmë plotësisht vlerat e njohura universalisht** siç janë artikuluar në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si standarde të përbashkëta të njerëzimit tonë të përbashkët. Ne bazojmë zotimet tona në këtë deklaratë F4R para së gjithash në bindjen tonë se fetë dhe besimet ndajnë vlera bërthamë të përbashkëta të respektit për dinjitetin njerëzor, drejtësinë dhe korrektësinë. Ne gjithashtu i bazojmë këto zotime në pranimin tonë të faktit se *“Secili ka detyrim ndaj bashkësisë ku vetëm aty i mundësohet zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij”*<sup>4</sup>. Detyra jonë është për të praktikuar atë që predikojmë, të angazhohemi plotësisht, të flasim dhe të veprojmë në terren në mbrojtje të dinjitetit njerëzor shumë më herët sesa që ai të kërcënohet në të vërtetë.

- *“O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni.” (Kurani 61: 2-3)*
- *“Hape gojën tënde në favor të memecit, në mbrojtje të të gjithë atyre që janë lënë pas dore. Hape gojën tënde, gjyko me drejtësi dhe mbro çështjen e të mjerit dhe të nevojtarit.” (Fjalët e urta 31:8-9)*

15. Si **normat fetare ashtu edhe kornizat ekzistuese ligjore ndërkombëtare** i atribuojnë përgjegjësi aktorëve fetarë. Fuqizimi i aktorëve fetarë kërkon veprime në fusha të tilla si legjislacioni, reformat institucionale, politikat publike mbështetëse dhe trajnim të përshtatur ndaj nevojave të aktorëve lokalë fetarë, të cilët shpesh janë një nga burimet kryesore të edukimit dhe ndryshimit shoqëror në fushat e tyre përkatëse të veprimit. Konventat dhe paktet ndërkombëtare kanë përcaktuar termat kryesore ligjore të tilla si gjenocid, refugjat, diskriminim dhe liri e fesë apo e besimit.<sup>5</sup> Të gjitha këto koncepte kanë rezonancë korresponduese në fetë dhe besimet e ndryshme. Përveç kësaj, deklaratat dhe rezolutat e shumta<sup>6</sup> japin elementet e roleve dhe përgjegjësi të aktorëve fetarë të cilat ne i përqafojmë dhe konsolidojmë në këtë deklaratë F4R.

16. Ne jemi dakord si qenie njerëzore **që ne jemi llogaridhënës ndaj të gjitha qenieve njerëzore** për të korigjuar mënyrën se si fetë portretizohen dhe shumë shpesh manipulohen. Ne jemi përgjegjës për veprimet tona, por edhe më shumë përgjegjës në qoftë se ne nuk veprojmë ose nuk veprojmë me vend dhe me kohë.

- *“Ne do ta pyesim secilin prej jush për të gjithë atë që keni thënë dhe keni bërë, sepse ju mbani përgjegjësinë” (Kurani, Assaafat, 24)*
- *“Vepra e secilit do të shfaqet.” (Bibla, 1 e Korintasve iii. 13)*

17. Ndërsa Shtetet e mbajnë përgjegjësinë kryesore për promovimin dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave për të gjithë, për të gëzuar individualisht dhe kolektivisht një jetë të dinjitetshme pa frikë dhe pa skamje, dhe për të gëzuar lirinë e zgjedhjes në të gjitha aspektet e jetës, ne si aktorë fetarë apo besimtarë individualë mbajmë një përgjegjësi të veçantë që të **ngritemi për njerëzimin tonë të përbashkët dhe dinjitet të barabartë të çdo qenieje njerëzore** në të gjitha rrethanat brenda vetë sferave tona të predikimit, mësimdhënies, udhëzimit shpirtëror dhe angazhimit shoqëror.

- *“Kush nga ju sheh një të keqe - le ta ndryshojë me dorë, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë - atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mundet këtë ta bëjë - atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët” (Hadith).*

18. **Bashkësitë fetare, udhëheqësit dhe pasuesit e tyre** kanë një rol dhe mbajnë përgjegjësi në mënyrë të pavarur nga autoritetet publike, si nën instrumentet ligjore kombëtare ashtu edhe ato ndërkombëtare. Duke u mbështetur në nenin 2 (1) të Deklaratës së OKB-së të vitit 1981 për Eliminimin e të Gjitha Formave të Mostolerancës dhe të Diskriminimit të bazuara në Fe apo Besim, “askush nuk do të jetë subjekt diskriminimi nga cilido shtet, institucion, grup personash apo person në bazë të fesë apo besimit”. Kjo dispozitë përcakton përgjegjësitë e drejtpërdrejta të institucioneve fetare, prijësve dhe madje edhe çdo individ brenda bashkësive fetare apo të besimit.

19. Për aq sa nocioni i kontrollit efektiv<sup>7</sup> siguron themelet për përgjegjësitë e aktorëve jo-Shtetërorë në kohë konflikti, ne shohim një arsytim të ngjashëm ligjor dhe etik në rastin e prijësve fetarë të cilët ushtrojnë një **shkallë të rritur të ndikimit mbi zemrat dhe mendjet e pasuesve të tyre** në çdo kohë.

20. Fjala është thelbësore për lulëzimin individual dhe komunitar. Ajo përbën një nga **mediumet** më thelbësore **për anët e mira dhe të liga të njerëzimit**. Lufta fillon në mendjet dhe kultivohet nga një arsytim i ushqyer nga avokimi shpesh i fshehur i urrejtjes. Fjala pozitive është gjithashtu mjet shërues i pajtimit dhe ndërtimit të paqes në zemrat dhe mendjet. Fjala është një nga fushat më strategjike të përgjegjësive që ne zotohemi për t’i marrë dhe për ta mbështetur njëri-tjetrin për zbatimin e tyre përmes kësaj deklarate F4R në bazë të praqjeve të artikuluar nga Plani i Veprimit i Rabatit.

21. Sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 20, paragrafi 2), Shtetet janë të detyruara të ndalojnë çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi dhe dhunë. Kjo përfshin **nxitjen e urrejtjes nga disa prijës fetarë në emër të fesë**. Për shkak të pozitës së folësit, kontekstit, përmbajtjes dhe shtrirjes së predikimeve, deklaratat e tilla nga prijësit fetarë ka mundësi që të përmbushin pragun e nxitjes së urrejtjes. Ndalimi i nxitjes së tillë nuk është i mjaftueshëm. Avokimi korrigjues për pajtim është po aq një detyrë, përfshirë edhe për prijësit fetarë, veçanërisht kur urrejtja është avokuar në emër të feve ose besimeve.

22. Udhëzimi më i qartë dhe më i fundit në këtë fushë është dhënë nga Plani i Veprimit i Rabatit i vitit 2012<sup>8</sup> i cili artikulon **tre përgjegjësitë specifike bërthamë të prijësve fetarë**: (a) Prijësit fetarë duhet të përmbahen nga përdorimi i mesazheve të mostolerancës apo shprehjeve të cilat mund të nxisin dhunë, armiqësi ose diskriminim; (b) Prijësit fetarë gjithashtu kanë një rol vendimtar për të luajtur duke folur në mënyrë të vendosur dhe menjëherë kundër mostolerancës, stereotipave diskriminuese dhe rasteve të gjuhës së urrejtjes; dhe (c) Prijësit fetarë duhet të jenë të qartë se dhuna nuk mund të tolerohet asnjëherë si përgjigje ndaj nxitjes së urrejtjes (p.sh. dhuna nuk mund të arsyetohet me provokim paraprak).

<sup>1</sup> Të gjitha citimet nga tekstet fetare apo të besimit u ofruan nga pjesëmarrësit e punëtorisë së Bejrutit në lidhje me fenë apo besimin e tyre dhe janë vetëm për qëllim ilustrues dhe nuk janë shteruese.

<sup>2</sup> OHCHR-ja ka organizuar takime të lidhura ndërkombëtare, seminare të ekspertëve dhe punëtori rajonale, duke përfshirë ato në Gjenevë (tetor 2008), Vjenë (shkurt 2011), Najrobi (prill 2011), Bangkok (korrik 2011), Santiago të Kilit (tetor 2011), Rabat (tetor 2012), Gjenevë (shkurt 2013), Aman (Nëntor 2013), Manama (2014), Tunis (tetor 2014 dhe prill 2015), Nikozi (tetor 2015), Bejrut (dhjetor 2015) dhe Aman (janar 2017).

<sup>3</sup> Shih Komitetin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, komenti i përgjithshëm nr. 22 (1993), UN Doc. CCPR/C/21/Rev.1/Add.4, para. 2.

<sup>4</sup> Neni 29, paragrafi 1, i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948).

<sup>5</sup> Këtu përfshihen Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit (1948); Konventa në lidhje me Statusin e Refugjatëve (1951); Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1966); Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979); Konventa kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar (1984); Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (1989); Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (1990); Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006); dhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë (2006).

<sup>6</sup> Këtu përfshihen Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948); Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Mostolerancës dhe të Diskriminimit të bazuara në Fe apo Besim (1981); Deklarata për të drejtat e

---

personave pjesëtarë të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore (1992); Parimet e Sjelljes për Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe OJQ-ve në Programet e Reagimit ndaj Fatkeqësive (1994); Deklarata e UNESCO-s mbi Parimet e Tolerancës (1995); Dokumenti përfundimtar i Konferencës Ndërkombëtare Konsultative mbi Edukimin në shkollë në lidhje me Lirinë e Fesë apo Besimit, Tolerancën dhe Mosdiskriminimin (2001); Parimet Udhëzuese të Toledos për Mësimdhënie në lidhje me Fetë dhe Besimet në Shkollat Publike (2007); Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njerëzve Vendës (2007); Deklarata e Hagës mbi “Besimin në të Drejtat e Njeriut” (2008); Parimet Camden mbi Lirinë e Shprehjes dhe Barazisë (2009); Rezoluta e Këshillit të të Drejtave të Njeriut 16/18 mbi Luftimin e Mostolerancës, Stereotipave Negativë dhe Stigmatizimit të, dhe Diskriminimit, Nxitjes për Dhunë dhe Dhunës ndaj Personave bazuar në Fe apo Besim (dhe Procesi i Stambollit, 2011); Plani i Veprimit i Rabatit për ndalimin e avokimit të urrejtjes kombëtare, racore apo fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë (2012); Korniza e Analizës për Krimet e Mizorisë (2014); Plani i Veprimit i Sekretarit të Përgjithshëm për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2015); si dhe Deklaratën Fez për parandalimin e nxitjes për dhunë që mund të çojë në krime të mizorisë (2015).

<sup>7</sup> Nën rrethana të caktuara, në veçanti kur aktorët jo-Shtetërorë ushtrojnë kontroll domethënës/efektiv mbi territorin dhe popullsinë (p.sh. si *de facto* autoritete), ata janë po ashtu të detyruar të respektojnë të drejtat ndërkombëtare të njeriut si bartës të detyrës (shih UN Docs. CEDAW/C/GC/30, para. 16; A/HRC/28/66, para. 54-55).

<sup>8</sup> Shih UN Doc. A/HRC/22/17/Add.4, annex, appendix, para. 36.